



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN sha

Elbasan, më 10. 05.2024

PROCESVERBAL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“BLERJE MATERIALE HIDRAULIKE”, Procedurë e hapur - mallra, me afat sipas kërkesave të AK”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **44115210-4**
Materiale hidraulike

VLERA E FONDIT LIMIT: 34 986 585 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë pesë) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetë-deklarimit”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të jetë i siguar për gjendjen aktuale të OE, për përmbushjen me sukses të kësaj kontrate.

b. Formularin e Ofertës sipas Shtojcës 1;

c. Listën e Çmimeve sipas Shtojcës 2.

Argumentimi: Kriteret e mësipërm (b, c) janë bazuar në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 15, “Përmbajtja e dokumenteve standarde të tenderit”, pika 2.

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është bazuar në Ligjin 162 datë 23. 12 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, dhe në VKM-në nr. 285 datë 19. 05. 2021 i ndryshuar, “Për Miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 30 “Sigurimi i ofertës”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;” dhe pika 2: “Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë...”, si dhe në VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

a) *licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”.*

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020-2021-2022), ku vlera mesatare e së cilës, të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së llogaritur të kontratës.

2.2.2 Kopje të vërtetuar të bilanceve për vitet (2021-2022-2023) të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ku bilancet e tre viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në përputhje me Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3: “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”, si dhe në VKM-në Nr. 285 datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 1: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare” dhe pika 2/b: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) “vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore kërkohet bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30. 01. 2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2021-2022-2023) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë këtyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 77 “Kërkesat për kualifikim” dhe në VKM-në Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 4: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”.

2.3.2 OE ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose distributor zyrtar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatë DVGW / WRAS ose ekuivalente, të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm për të gjithë mallrat që kanë kontakt me ujin e pijshëm, të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor”, si dhe në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”. Me anë të këtij kriteri AK kërkon të garantohet se OE pjesëmarrës, i kanë mundësitë dhe kapacitetet e nevojshme në përmbushjen me suskese të kontratës.

2.3.4 Operatorët Ekonomik në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin nga një mostër për çdo tip produkti, **sipas tabelës së mostrave të kërkuara nga AK, në shtojca 5 e DST.**

Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sha

Data e dorëzimit të mostrave të jetë data dhe ore e hapjes së ofertave. Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

– Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti.

Mos-dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për s'kualifikim. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s'kualifikohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në VKM-në Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

Me anë të kësaj kërkesë, Autoriteti Kontraktor kërkon të njihet nga afër me artikujt objekt prokurimi, për cilësinë dhe garancinë e punës së tij në vijim. OE që do të paraqesin mostra në ditën dhe orën e caktuar nga AK, duhet të paraqesin një vërtetim/autorizim që vërtetojnë përfaqësinë e OE, dhe një dokument identifikimi të përfaqësuesit.

2.3.6 Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin e titulluar Ofertë Teknike i paraqitur nga AK në formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë listën e artikujve që kërkohen. Dokumenti Ofertë Teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

- Nr. i artikullit
- Emërtimi i artikullit
- Emri i kompanisë prodhuese
- Emri i katalogut
- Kodi i artikullit ose numri i faqes në katalog ose
- Dokumente të noterizuar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe në VKM-në Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44 “Kërkesat e cilësisë”. Me anë të këtij kriteri autoriteti kontraktor kërkon të jetë i garantuar për cilësinë dhe kërkesat sipas specifikimeve teknike për artikujt objekt prokurimi, për relizimin me sukses të kësaj kontrate.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një Deklaratë që merr përsipër transportin dhe lëvrimin e mallrave drejt ambienteve magazinuese të Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr. 162 datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe në VKM-në Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5 “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.”.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s'kualifikim

Njësia e Prokurimit